



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

RREGULLORE

PËR

VEPRIMTARINË E AGJENTIT TË SHOQËRISË SË BROKERIMIT NË TITUJ

Miraturar me Vendimin e Bordit nr. 71, datë 27.03.2019
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 248, datë 19.12.2019
Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 72, datë 22.05.2020

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është njohja e veprimtarisë së agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj si veprimtari e lidhur me transaksionet me titujt.

Neni 2

Objekti

Kjo rregullore përcakton rregullat në lidhje me njohjen dhe monitorimin e veprimtarisë së agjentit të shoqërisë së brokerimit në tituj, i cili vepron në emër dhe për llogari vetëm të një brokeri të licencuar për titujt në territorin e Republikës së Shqipërisë, apo shoqëri e licencuar nga Autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, anëtare të BE-së, në përputhje me kufizimet e licencës përkatëse.

Neni 3

Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 42, pika 10, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.

Neni 4

Terminologjia

Në këtë rregullore termi:

“Agjent” – nënkupton shoqërinë aksionare që vepron në emër dhe për llogari të një shoqërie brokerimi të licencuar për të ushtruar veprimtari në titujt.

“Shoqëri brokerimi në tituj” – nënkupton shoqërinë e brokerimit të licencuar sipas Rregullores nr. 165, datë 23.12.2008 “Për Licencimin e Shoqërive të Brokerimit/Këshillimit, Brokerit dhe Këshilltarit të Investimeve”, e ndryshuar, apo firmën e investimit të licencuar nga një Autoritet rregullator dhe mbikëqyrës, anëtar i BE-së.

“Platformë tregtimi” – nënkupton një website ose program kompjuterik me një ndërfaqe grafike që përdoret për të tregtuar tituj dhe instrumenta financiare nëpërmjet një rrjeti elektronik të komunikimit mes bursave, sistemeve alternative të tregtimit, dhe që është nën administrimin e një shoqërie brokerimi.

Neni 5

Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë personat juridikë që kërkojnë të njihen si agjentë të një shoqërie brokerimi të licencuar brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe që kryejnë veprimtari për klientë shqiptarë apo të huaj.

Për efekt të kësaj rregulloreje, agjenti kryen aktivitet vetëm për investitorët e vendeve ku shoqëria e brokerimit e licencuar është e autorizuar për të ushtruar aktivitet, sipas licencës përkatëse.

Neni 6

Veprimtaria e agjentit

Veprimtaria e agjentit konsiston në promovimin e produkteve dhe shërbimeve të investimeve të ofruara nga shoqëria e brokerimit në emër të të cilit vepron, nxitjen apo inkurajimin e klientëve për të investuar në tituj dhe instrumenta financiare, si dhe ofrimin e informacionit për klientët në lidhje me investimet në titujt dhe instrumentet financiare sipas burimeve të certifikuara nga shoqëria e brokerimit.

Neni 7
Përfshirje nga veprimtaria e agjentit

Sipas kësaj rregulloreje nuk konsiderohet veprimtari e agjentit, veprimtaria që lidhet vetëm me:

- a. Mbështetjen e klientit në lidhje me depozitimin e dokumentacionit të kërkuar në platformën e shoqërisë së brokerimit, si dhe përcjelljen e këtij dokumentacioni tek shoqëria e brokerimit;
- b. Përditësimin e dokumentacionit të klientëve sipas kërkesave të shoqërisë së brokerimit të licencuar;
- c. Ofrimin e suportit teknik të klientëve në lidhje me platformat e administruara nga shoqëria e brokerimit, si dhe procedurën e hapjes së llogarisë;
- d. Kryerjen e shërbimeve “Back Office”;
- e. Kryerjen e çdo shërbimi, të ngjashëm me sa më sipër.

Neni 8
Papajtueshmëria me veprimtarinë e agjentit

Veprimtaria e agjentit është e papajtueshme me veprimtarinë e brokerimit dhe këshillimit në titujt.

Neni 9
Kriteret për njohjen e agjentit

1. Veprimtaria e agjentit mund të kryhet vetëm nga një shoqëri, e organizuar si shoqëri aksionare.
2. Shoqëria vepron vetëm në emër të një shoqërie brokerimi të licencuar, sipas një kontrate paraprake apo letër angazhimi mes palëve.
3. Shoqëria zotëron kapitalin e kërkuar.
4. Shoqëria provon se punonjësit e saj janë të aftë dhe të përshtatshëm.
5. Shoqëria ka hartuar dhe miratuar rregullat e brendshme sipas kërkesave të kësaj rregulloreje.
6. Administratori i shoqërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës/administrues, si dhe punonjësit e njësisë që promovon produktet dhe shërbimet e Brokerit në titujt dhe komunikojnë me klientët të mos kenë qenë dënuar për ndonjë vepër penale dhe të mos kenë çështje penale në proces.

Neni 10
Dokumentacioni për njohjen e agjentit

Shoqëria e cila kërkon të kryejë veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit, duhet të depozitojë dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kërkesën për të marrë miratimin për të kryer veprimtarinë e agjentit të shoqërisë së brokerimit të licencuar;
- b. Statutin e shoqërisë;
- c. Informacion mbi aksionaret dhe burimin e kapitalit;
- d. Letrën e angazhimit të agjentit me shoqërinë e brokerimit në tituj, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë;
- e. Licencën e shoqërisë së brokerimit në tituj, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë, lëshuar nga Autoriteti përkatës;
- f. Dokument që zotëron kapitalin e kërkuar sipas nenit 11, të kësaj rregulloreje;
- g. Dokument që vërteton se administratori i shoqërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës/administrues, si dhe punonjësit e njësive që promovon produktet dhe shërbimet e shoqërisë së brokerimit në titujt dhe komunikojnë me klientët të mos kenë qenë dënuar për ndonjë vepër penale dhe të mos kenë çështje penale në proces;
- h. Dokumenta që vërtetojnë se punonjësit e njësive që promovon produktet dhe shërbimet e brokerit në titujt dhe komunikojnë me klientët kanë njohuritë e duhura, si dhe certifikimet përkatëse sipas kërkesave të kuadrit rregullator ku është licencuar brokeri në titujt;
- i. Rregulloret e brendshme të veprimtarisë si:
 - i. Mënyrat e promovimit të shërbimeve të brokerit;
 - ii. Mënyra e komunikimit me klientët;
 - iii. Procedurat e njohjes së klientëve;
 - iv. Rregullat për parandalimin e pastrimit të parave;
 - v. Mënyra e shqyrtimit dhe zgjidhjes së ankesave të klientëve.
- j. Rregullore të brendshme mbi vlerësimin e performancës dhe përshkallëzimin e shkeljeve;
- k. Dokumenta që vërtetojnë se agjenti është në përputhje të plotë me kërkesat organizative në nenin 13, të kësaj rregulloreje;
- l. Dokumenta që vërtetojnë se ka vendosur një sistem të regjistrimit të telefonatave dhe se ka vendosur një funksion “Përputhshmërie” i cili ka akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha komunikimeve që punonjësit kryejnë me klientët.

Neni 11

Kapitali

Kapitali i shoqërisë që vepron si agjent nuk duhet të jetë me pak se 6,000,000 Lekë.

Neni 12

Përgjegjësitë e shoqërisë së brokerimit

1. Shoqëria e brokerimit, në emër të së cilës vepron agjenti duhet:

- a. Të monitorojë veprimtarinë e agjentëve të saj, në mënyrë që të sigurojë që ata veprojnë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e kësaj rregulloreje;
 - b. Të sigurojë që agjenti është transparent me klientin në lidhje me identitetin e tij dhe shoqërinë e brokerimit në emër të së cilës është duke vepruar;
 - c. Të marrë masa adekuate për të shmangur çdo ndikim negativ nga veprimtaria e agjentit që cënojnë reputacionin e vetë shoqërisë së brokerimit;
 - d. Të sigurojë që agjenti në titujt posedon njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të përmbushur kërkesat relevante rregullatore dhe ligjore dhe standardet e etikës së biznesit.
2. Niveli dhe mjaftueshmëria e njohurive që kërkohen për agjentin duhet të përcaktohen nga “shoqëria e brokerimit të licencuar”, duke reflektuar qëllimin dhe shkallën e shërbimeve përkatëse të ofruara.

Neni 13

Kërkesat organizative në lidhje me agjentin

1. Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit duhet të punësojë punonjës me kualifikim dhe përvojën e duhur në ofrimin e shërbimeve për klientët.
2. Shoqëria, në mënyrë të vazhdueshme, duhet të sigurojë që punonjësit e tij vazhdojnë të posedojnë kualifikime të duhura nëpërmjet kryerjes së trajnimeve të vazhdueshme.
3. Në rast se një punonjës nuk posedon njohuritë dhe kompetencat e nevojshme, punonjësi mund të ofrojë shërbimet përkatëse vetëm nën mbikëqyrje dhe për një periudhë të kufizuar kohore.
4. Shoqëria (agjenti) duhet të përcaktojë qartë rolet dhe përgjegjësitë e punonjësve dhe të sigurojë që ata dinë, kuptojnë dhe zbatojnë politikatat dhe procedurat e brendshme të “Brokerit të licencuar në titujt” për të siguruar përputhjen me kërkesat rregullatore përkatëse.
5. Agjenti duhet të sigurojë që shpërblimi i punonjësve të mos krijojë konflikte interesi, si dhe të jetë në përputhje me rregulloret përkatëse të shtetit ku është i licencuar brokeri për të cilin vepron.
6. Agjenti duhet të sigurojë që punonjësit përdorin emrin e tyre të vërtetë dhe të mos japin informacione të rreme në lidhje me kredencialet e tyre përfshirë vendndodhjen kur komunikojnë me klientët.
7. Agjenti duhet të përdorë një format standard për pyetjet dhe përgjigjet më të shpeshta, duke deklaruar informacionin që mund të ndahet me klientët e cila jepet nga Brokeri.
8. Agjenti duhet të sigurojë që praktikatat e tilla si thirrjet telefonike të shpeshta dhe të përsëritura dhe/ose përdorimi i gjuhës agresive dhe/ose ushtrimi i presionit, duke i kërkuar/këshilluar klientin të investojnë dhe/ose të depozitojnë fonde nuk duhet të ndodhin.
9. Agjenti duhet të ketë procedurat/kontrollet e duhura për vlerësimin e performancës së stafit, si dhe të marrë masa ndëshkuese në rastet kur vlerësimi është i dobët ose negativ dhe/ose kur gjykohet se veprimet e një punonjësi të veçantë janë në kundërshtim me dispozitat e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

10. Në rastet kur punonjësi është shkarkuar për një shkelje serioze të kërkesave rregullatore, informacioni i një shkarkimi të tillë (së bashku me të gjitha faktet relevante) duhet të referohet pranë AMF-së, si dhe të referohet pranë organeve të tjera ligjzbatuese për shkelje të mundshme penale.

Neni 14

Nevoja për njohuri dhe kompetencë

Agjenti duhet të sigurojë që punonjësit kanë njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për të:

- a. Kuptuar karakteristikat kryesore, rrezikun dhe tiparet e produkteve të investimit që promovohen, duke përfshirë çdo implikim të përgjithshëm në anën fiskale dhe kostot që do të duhet të përballojë klienti në lidhje me transaksionet;
- b. Patur kujdes në dhënien e informacionit në lidhje me produktet që karakterizohen nga nivele më të larta të kompleksitetit;
- c. Kuptuar shumën totale të kostove dhe pagesave që do të duhet të paguhet nga klienti në kontekstin e transaksioneve për një produkt investimi, ose shërbimi investimi;
- d. Kuptuar karakteristikat dhe qëllimin e shërbimeve të investimeve;
- e. Kuptuar se si funksionojnë tregjet financiare dhe si ato ndikojnë në vlerën dhe çmimet e produkteve të investimit për të cilat u ofrohet informacion klientëve;
- f. Kuptuar ndikimin e të dhënave ekonomike, ngjarjeve kombëtare/rajonale/globale në tregje dhe mbi vlerën e produkteve të investimeve në të cilat ato japin informacion;
- g. Kuptuar dallimin e performancës së kaluar dhe skenarëve të ardhshëm të performancës, si dhe kufizimet e parashikimeve;
- h. Kuptuar çështjet që lidhen me abuzimin e tregut dhe pastrimin e parave;
- i. Vlerësuar të dhënat relevante për produktet e investimit për të cilat ai jep informacion, si Dokumentet kryesore të informacionit për investitorin, prospektet, pasqyrat financiare ose të dhënat Financiare;
- j. Kuptuar strukturat specifike të tregut për produktet e investimit në të cilat ato ofrojnë informacion për klientët;
- k. Patur njohuri themelore të parimeve të vlerësimit për llojin e produkteve të investimit në lidhje me të cilat jepet informacioni.

Neni 15

Shqyrtimi, njohja dhe regjistrimi i veprimtarisë së agjentit në titujt

1. Autoriteti shqyrton kërkesën për veprimtarinë e agjentit në titujt pas regjistrimit të shoqërisë në QKB.
2. Autoriteti, brenda 2 muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit të plotë, nga ana e kërkesës, njeh ose refuzon njohjen për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në titujt.
3. Pas njohjes së shoqërisë për veprimtarinë e agjentit, agjenti regjistrohet në regjistrin publik të Autoritetit, në faqen zyrtare të tij.

4. Njohja e veprimtarisë së agjentit shoqërohet me pagesën e tarifës për llogari të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Neni 15/1

Njohja/regjistrimi i kushtëzuar i veprimtarisë së agjentit në titujt

1. Autoriteti mund të miratojë njohjen/regjistrimin e kushtëzuar të veprimtarisë së agjentit në tituj.
2. Në njohjen/regjistrimin e kushtëzuar, Autoriteti mund të kërkojë plotësimin e dokumentacionit sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje, brenda një afati të përcaktuar.”

Neni 16

Detyrimet e agjentit

1. Shoqëria pas regjistrimit në QKB, depoziton në Autoritet një kopje të ekstraktit të regjistrimit, si dhe kontratën me brokerin e titujve, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë.
2. Shoqëria e agjentit në tituj detyrohet të respektojë kërkesat e Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.
3. Shoqëria e agjentit në njoftimet publike apo reklamat e publikuara në mjetet e komunikimit në masë dhe në mjetet e komunikimit elektronik duhet të deklarojë dukshëm rrezikun që mbart tregtimi në platformën e tregtimit. Teksti i njoftimeve publike apo të reklamave në lidhje me rrezikun për klientët shqiptare, përpara se të publikohen, depozitohen në Autoritet. Nëse Autoriteti brenda tre ditëve pune nga paraqitja e tekstit të njoftimit apo reklamës nuk e ndalon zyrtarisht publikimin, agjenti e publikon atë.

Neni 17

Detyrimi për raportim

1. Shoqëria e agjentit në tituj, brenda muajit mars të çdo viti, depoziton në Autoritet pasqyrat financiare vjetore dhe raport të plotë mbi veprimtarinë dhe respektimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria e agjentit në tituj, raporton çdo 3-muaj në AMF mbi veprimtarinë e kryer, sipas formatit bashkëngjitur kësaj rregulloreje, si dhe mbi nivelin e kapitalit të kërkuar.

Neni 18

Vlefshmëria e njohjes së veprimtarisë së agjentit

1. Vlefshmëria e njohjes/regjistrimit të veprimtarisë së agjentit nga Autoriteti është e lidhur me afatin e vlefshmërisë së kontratës me shoqërinë e brokerimit për llogari të së cilës punon.

2. Në çdo rast të rinovimit të kontratës, agjenti depoziton në Autoritet kontratën me shoqërinë e brokerimit.
3. Në rast të mbylljes së kontratës me një shoqëri brokerimi dhe nënshkrimit të një kontrate me një shoqëri tjetër brokerimi, agjenti njofton Autoritetin dhe depoziton kontratën e re, si dhe licencën e shoqërisë së brokerimit në titujt, në emër dhe për llogari të të cilit do të veprojë, në përputhje me nenin 10 pika (e) të kësaj rregulloreje.
4. Drejtoria përgjegjëse pasqyron ndryshimet në regjistrin publik të Autoritetit, në faqen zyrtare të tij dhe informon Bordin e Autoritetit.

Neni 19

Sanksionet

Mosrespektimi i kërkesave të kësaj rregulloreje, shoqërohet me sanksionet përkatëse, referuar Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për Titujt”.

Neni 20

Shfuqizime

Vendimi nr. 55, datë 30.03.2011 “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, i ndryshuar shfuqizohet me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 21

Dispozita kalimtare

Të gjitha subjektet, të miratuara për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit të shoqërisë së brokerimit të licencuar sipas Vendimit nr. 55, datë 30.03.2011, duhet të përshtatin veprimtarinë e tyre në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

FORMULAR RAPORTIMI

MBI

VEPRIMTARINË E AGJENTIT TË SHOQËRISË SË BROKERIMIT NË TITUJ

Emri i Shoqërisë: XXXX__

Periudha raportuese

1. TË DHËNA MBI SHOQËRINË

A. Statusi i shoqërisë së agjentit		
1	NIPT	
2	Adresa Kryesore	
3	Kodi postar	
4	Qyteti/shteti	
5	Nr. i telefonit	
6	Nr. i celularit	
7	E-mail	
8	Website	

B. Administratori dhe anëtarët këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit			
	Emër Mbiemër	Data e emërimit	Nr. kontakti/e-mail
1			
2			
3			
4			

C. Të dhëna financiare		
1	Emri shoqërisë audituese, e cila ka audituar raportet financiare më të fundit	
2	Emrat e bankave me të cilat operon shoqëria	
3	Shuma e kapitalit aksionar	
4	Aksionarët e shoqërisë	

D. Të dhëna për punonjësit që komunikojnë me klientin					
		Periudha e meparshme	Shtesa	Pakesime	Periudha raportuese
1	Nr. i të punësuarve që promovojnë produktet financiare				
2	Nr. total i punonjësve				
3	Nr. total i personave të trajnuar gjatë periudhës				

2. TË DHËNA MBI VEPRIMTARINË E AGJENTIT

A. Të dhëna për shoqërinë e brokerimit në tituj		
1	Emri i shoqërisë	
2	Numri i licencës	
3	Data e lëshimit të licencës	
4	Adresa	
5	Autoriteti Mbikëqyrës	

B. Veprimtaria e agjentit të shoqërisë së brokerimit		
1	Vendndodhja e investitorëve që kontaktohen	
2	Emërtimi i platformës së tregtimit	

C. Të dhëna për investitorët në territorin e R.Sh.		
1	Nr. i investitorëve individualë	
2	Nr. i investitorëve Institucionalë	

D. Aktiviteti i investitorëve në territorin e R.Sh.		
1	Shuma e depozituar (ekuivalenti në lekë)	
2	Shuma e tregtuar (ekuivalenti në lekë)	
3	Nr. i transaksioneve të realizuara	

Nënshkrimi i Personit të Autorizuar

Data e plotësimit

Shënime:

1. Ky formular plotësohet çdo 3-muaj. Agjenti i miratuar detyrohet që të dorëzojë në AMF formularin e plotësuar brenda datës 5 të muajit pasardhës, sipas periudhave respektive.
2. Ky formular shoqërohet edhe nga Deklarata, sipas formatit-tip më poshtë.

Shoqëria e agjentit[Emri i shoqërisë]

Shoqëria e brokerimit në emër të së cilës punon [Emri i shoqërisë]

DEKLARATË – TIP

Në cilësinë e administratorit/kryetarit të këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit të shoqërisë [Emri i shoqërisë] deklaroj se:

Për aq sa kam dijeni dhe besim:

1. Kontrata me shoqërinë e brokerimit [Emri i shoqërisë] është e vlefshme deri në datën.....;
2. Kryejmë aktivitetet vetëm për investitorët e vendeve ku shoqëria e brokerimit është e autorizuar për të ushtruar aktivitetet, sipas licencës përkatëse;
3. Administratori i shoqërisë, anëtarët e këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit, si dhe punonjësit që promovojnë produktet dhe shërbimet e shoqërisë së brokerimit në titujt dhe komunikojnë me klientët nuk janë të dënuar për ndonjë vepër penale dhe nuk kanë çështje penale në proces;
4. Niveli dhe mjaftueshmëria e njohurive të punonjësve që promovojnë produktet dhe shërbimet e shoqërisë së brokerimit në titujt janë në përputhje me kërkesat e shoqërisë së brokerimit, duke reflektuar qëllimin dhe shkallën e shërbimeve që ofron kjo shoqëri;
5. Të gjithë punonjësit që promovojnë produktet dhe shërbimet e shoqërisë së brokerimit në titujt vazhdojnë të posedojnë kualifikime të duhura nëpërmjet kryerjes së trajnimeve të vazhdueshme;
6. Gjate komunikimit me klientët, punonjësit përdorin emrin e tyre të vërtetë dhe nuk japin informacione të rreme në lidhje me kredencialet e tyre përfshirë vendndodhjen nga ku komunikojnë;
7. Monitorojmë në vazhdimësi komunikimin e punonjësve me klientët duke mos lejuar thirrje telefonike të shpeshta dhe të përsëritura, si dhe duke mos lejuar përdorimin e gjuhës agresive apo ushtrimin e presionit, duke i kërkuar klientit të investojë fondet.

Jam i ndërgjegjshëm se çdo deklaram i pasaktë dhe fshehje e fakteve do të jetë shkak dhe objekt i sanksioneve ligjore.

Deklaruesi (Emër, Mbiemër, Firmë)

Data e nënshkrimit